


# UDHËZUES

## REFORMË KOMBËTARE NË SEKTORIT UJËSJELLËS – KANALIZIME

### RIORGANIZIMI I SHËRBIMEVE TE FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE PËR TË PËRMBUSHUR NEVOJAT E NJERËZVE



# **UDHËZUES**

**REFORMË KOMBËTARE NË SEKTORIT  
UJËSJELLËS – KANALIZIME**

**RIORGANIZIMI I SHËRBIMEVE TE FURNIZIMIT  
ME UJË DHE KANALIZIMEVE PËR TË  
PËRMBUSHUR NEVOJAT E NJERËZVE**

# PËRMBAJTJA

1. **HYRJA DHE OBJEKTIVAT E VENDIMIT PËR REFORMËN NË SEKTORIN UJESJELLES KANALIZIME..... 3**
  
2. **KOPJE ZYRTARE E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR REFORMËN NË SEKTORIN UJESJELLES KANALIZIME DHE MODEL PËR STATUT TË RI PËR SHOQËRIN AKTUALE ME SHPJEGIME TË MËTEJSHME ..... 7**
  
3. **ÇËSHTJE QË DUHEN TË MERREN PARASYSH DHE SHQYRTOHEN NË PROCESIN E HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË PLANIT TË TRANZICIONIT..... 34**
  
4. **STRUKTURA DHE RËNDËSIA E PLANIT 5-VJEÇAR PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS DHE E PLANIT TË BIZNESIT ..... 43**

## 1. HYRJA DHE OBJEKTIVAT E VENDIMIT PËR REFORMËN NË SEKTORIN UJESJELLES KANALIZIME

### 1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Ky udhëzues është hartuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës me asistencë teknike të USAID-së për të shërbyer si udhëzues praktik për të kuptuar qëllimin e Reformës në Sektorin e Ujësjetës-Kanalizime, të miratuar me VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura". Gjithashtu, kjo reformë sektoriale hartua për të mbështetur reformën administrative-territoriale sipas Ligjit Nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" me qëllim sigurimin e shërbimeve UK për publikun.

Së dyti, udhëzuesi ofron këshilla praktike që çdo bashki mund t'i marrë parasysh në hartimin e planit të tranzicionit që duhet të hartohet në përputhje me kushtet e tyre të veçanta duke përfshirë të gjitha çështjet ligjore, administrative, procedurale dhe operacionale në lidhje me shërbimin e gjithëpopullsisë me ujë dhe me kanalizime brenda kufijve të rinj administrativë të bashkisë.

Pasi të jetë hartuar dhe vënë në zbatim plani i tranzicionit, udhëzimi vijon me ofrimin e këshillave për çdo bashki dhe shoqëri të saj UK, për hartimin e një Plani Veprimi 5-vjeçar për Përmirësimin e Performancës, përfshirë këtu edhe një plan 5-vjeçar biznesi. Këto plane do të jenë instrumente të rëndësishme për drejtuesit e shoqërive me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë financiare të funksionimit të Shoqërive UK .

Politika e qeverisë qendrore, në të ardhme, është të ridrejtojë subvencionet e saj në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në mënyrë të atillë që Shoqëritë do të marrin mbështetje specifike financiare sipas nevojave të përcaktuara sociale në zona të veçanta shërbimi dhe jo thjesht si subvencion për të metat operative dhe të mirëmbajtjes në performancën financiare. Prandaj, nëse Shoqëritë UK funksionojnë në mënyrë të atillë që të mos jenë në gjendje të mbulojnë shpenzimet e tyre operacionale dhe të mirëmbajtjes nga tarifat që aplikojnë, atëherë çdo deficit financiar do të duhet të mbulohet nga bashkia që është edhe pronari i ligjshëm i Shoqërisë.

## 1.2 Arsyetimi për Hartimin dhe Zbatimin e Reformës në Sektorin UK

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë hapa të qarta drejt menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Sektori ishërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur është një nga sektorët me rëndësi të veçantë dhe ndjeshmëri, pasi ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve.

Në kuadër të reformës territoriale administrative, miratuar me Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë,” lindi nevoja për riorganizimin e sektort UK.

Ligji nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, po ashtu edhe ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parasheh shërbimin të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, si një funksion të vetin të qeverisjes vendore.

Me ligjin 30/2015 «Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” u përcaktua se bashkia është njësi baze e qeverisjes vendore. Gjithashtu me anë të këtij ligji u përcaktua se “...Procedurat dhe masat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër shtetëror në njësitë e qeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave...” Në këtë kontekst, lindi si domosdoshmëri rregullimi i pasojave të riorganizimit territorial edhe në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

Në përputhje me sa më sipër, por edhe në kuadër të nevojës për një performancë sa më të mirë të sektorit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës së bashku me Ministrinë e Shtetit per Çështjet Vendore hartuan Vendimin 63/2016 të Këshillit të Ministrave, i cili nëpërmjet mekanizmave që ofron, synon bërjen të mundur të një shërbimi sa më cilësor për qytetarët. Ky vendim vjen si pasojë e një analize të thellë të sektorit, të kapaciteteve menaxhuese dhe burimeve njerëzore të tij, të situatës financiar ekonomike, si dhe të gjendjes teknike. Vlen të theksohet se në fazën e hartimit të tij, u zhvilluan konsultime me të gjithë aktorët e sektorit.

Gjithashtu ky vendim është në përputhje të plotë dhe me VKM nr 510/2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar, në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale.” Kështu, disa nga përparësitë e këtij vendimi, janë:

- Mundëson njehsimin e zonës së juridiksionit me zonën e shërbimit të sha UK-ve, duke bërë të mundur që çdo shtetasi t'i ofrohet shërbim nga një prej sha UK-ve.
- Thekson qasjen e shpërndarjeve të investimeve në përputhje me performancën e Shoqërisë, e cila do të detajohet me akte të tjera nënligjore, si dhe në përputhje me dokumentat strategjike.

- Prezanton institucionalizimin e një projekti kombëtar të trajnimit dhe certifikimit të stafeve të sha UK-ve sipas programeve që do të miratohen nga ministria e linjës.
- Si aneks i projekt vendimit, bashkëngjitet “Statuti Tip”, i cili është i detajuar në mënyrë të tillë që mundëson që sha UK të ketë mundësinë të mirëfunksionojë.
- Nëpërmjet Statutit Tip, jepen në mënyrë të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë e Bashkisë (kryetarit të Bashkisë, i cili përfaqëson bashkinë në Asamblenë e Përgjithshme) si dhe të sha UK (administratorit/Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë) duke orientuar drejt menaxhimit të Shoqërisë nëpërmjet arritjes së objektivave; kontratë pune me tregues konkretë performance, të cilët janë të matshëm e të miratuar nga ministria e linjës, mosrealizimi i të cilave sjell shkarkimin e Drejtorit.
- Vendosen kritere konkrete në caktimin e administratorit të sha UK, mospërbushja e të cilëve sjell pavlefshmëri të emërimit të tij. Gjithashtu standardizohet funksionimi i Shoqërisë duke detajuar kriteret e emërimit si dhe detyrat e përgjegjësitë e dy drejtorëve të sha UK, Drejtorit Teknik dhe Drejtorit Tregtar, të cilët emërohen nga Administratori/Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë.
- Mundëson një agregim të njësive që aktualisht ofrojnë shërbim me ato që ofronin shërbim në kuadër të komunave si ish njësi të qeverisjes vendore. Pra tashmë do të kemi sha UK aktuale, të cilat do të administrojnë edhe njësitë e shërbimit të cilat vepronin në varësi të komunave.
- Standardizon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të operatorëve që ofrojnë këtë shërbim duke propozuar organizimin e tyre në një formë më operacionale dhe më të thjeshtë, por në të njëjtën kohë duke ruajtur parimin e komercializimit të këtij shërbimi, pra organizimit në shoqëri tregtare.
- Propozohet vazhdimi i organizimit si shoqëri aksionere, por me një shkallë administrimi. Këshilli i administrimit ushtron funksione administrimi e mbikqyrje. Gjithashtu ulen kostot në menaxhimin e shoqërive, pasi këshillat e administrimit propozohen të jenë me 3 anëtarë, për përzgjedhjen e të cilëve, vendosen kritere të qarta e të detyrueshme (ndryshe nga këshillat mbikqyrës, të cilët në vlerësimin e të gjithë aktorëve të sektorit kanë rezultuar joefiçentë, madje ne disa raste edhe pengues). Një prej tre anëtarëve të këshillave të administrimit është edhe Drejtori i Përgjithshëm i sha UK. Për shkak të rëndësisë së administrimit dhe mbikqyrjes së veprimtarisë së sha UK, parashikohet mbledhja e këshillit të administrimit të paktën një herë në muaj.
- Mundëson që çdo sha UK të ofrojë tashmë edhe shërbimin e ujësjellësit dhe atë të kanalizimeve (aktualisht disa prej sha UK ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me uje), si dhe të trajtimit të ujërave të ndotur në raste ku ka impiante.

- Bën të mundur zbatimin e ligjit 8102/1996 “Për kuadrin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, duke detyruar secilën prej sha UK-ve të liçensohet. Kujtojmë se deri tani ka pasur operatorë që kanë ofruar shërbimin të paliçensuar.
- Orienton drejt agregimit të mëtejshëm të shërbimit, pra drejt bashkimit të sha UK-ve, duke rritur ekonominë e shkallës.
- Detajon mënyrën e përdorimit të fitimit të sha UK (neni 27 i draft Statutit Tip), duke detyruar sha UK të investojnë fitimin në lidhje me plan bizneset e miratuara dhe nevojat për investime.

**2. KOPJE ZYRTARE E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR REFORMËN NË SEKTORIN UJESJELLES KANALIZIME DHE MODEL PËR STATUT TË RI PËR SHOQËRIN AKTUALE ME SHPJEGIME TË MËTEJSHME**

Në këtë pjesë të udhëzuesit jepet teksti zyrtar i Vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me reformën në UK, si dhe shtojcat e VKM-së, ku jepet një statut tip që kërkohet të miratohet nga asambleja e Shoqërisë, pasi bashkia të ketë riorganizuar Shoqërinë që do të ofrojë shërbimet UK.

Pas çdo paragrafi apo seksioni me numër është dhënë një shpjegim i zgjeruar për të siguruar nivelin më të mundshëm të të kuptuarit të qëllimit të shprehur në VKM si dhe në statutin e ri tip të dhënë në të.

---

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**V E N D I M**

**Nr. 63, datë 27.01.2016**

**PËRRIORGANIZIMIN E OPERATORËVE QË OFROJNË SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË të PIJSHËM, GRUMBULLIMIN, LARGIMIN DHE TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 213 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të shkronjave “a” e “b”, të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave.



**V E N D O S I:**  
**K R E U I**

**RIORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

1. Riorganizimin e të gjitha shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së re administrativo-territoriale, në përputhje me ligjin nr.115/2014, “Për ndarjen administrativeo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Me riorganizim të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë do të kuptojmë ndryshimet në kapitalin e shoqërive aksionere UK ekzistuese: transferimin e aksioneve të shoqërive tregtare? ujësjellës-kanalizime, në pronësi të njësive që shkrihen, (ish njësi të qeverisjes vendore, komunë ose bashki) tek bashkitë e konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, me juridiksion territorial sipas ndarjes së re administrativo-territoriale; gjithashtu edhe krijimin e shoqërive të reja në njësi të qeverisjes vendore të cilat nuk kane një të tille.

2. Të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura organizohen si shoqëri aksionare, sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Ligji nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar njeh sistemin me dy nivele dhe me një nivel administrimi të shoqërive aksionere. Në sistemin me dy nivele kemi qartazi të ndarë këshillin mbikqyrës me funksione kontrolli dhe administratori me funksioneve administrimi, ndërsa sistemi me një nivel parashikon këshillin e administrimit si të vetmin organ që ka njëkohësisht të dy funksionet, edhe ato të administrimit edhe ato të mbikqyrjes. VKM në pikën 2 ka vendosur pikërisht për këtë të fundit.

3. Bashkive u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., aktuale, në pronësi të ish-njësive të qeverisjes vendore të shkrira, sipas ndarjes së re administrativo-territoriale. Bashkitë ndjekin procedurat e kalimit të aksioneve në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Bashkitë e konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, detyrohen të bëjnë transferimin aksionarëve të shoqërive ujësjellës-kanalizime. Ish njësitë e qeverisjes vendore të shkrira, të cilat kanë administruar shoqëritë e tyre UK, do t’ia kalojnë të gjithë kapitalin që kane në zotërim, Shoqërisë aksionere të UK të Bashkisë në të cilën tashme bëjnë pjesë, sipas ndarjes së re administrativo - territoriale.

4. Në ato bashki, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, bashkia, brenda datës 31 dhjetor 2016, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrativo-territoriale.

Pika 4 e VKM ka të bëjë me rastin kur në Bashkinë e re nuk kemi të organizuar, në formën e një shoqërie aksionere, shërbimin e furnizimit të ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Detyra e Bashkisë në këtë rast është të përgatisë dokumentacionin ligjor, që kërkon transformimin e një Shoqërije shtetërore?? në shoqëri aksionere në përputhje me ligjin nr. 7926, dt. 20.04.1995 “Për transformimin e Shoqërive shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar. Proçedura standard për këtë qëllim është në fuqi dhe deri më tani është kryer nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Alternativë tjetër për këtë pikë të VKM, është krijimi i një shoqërie aksionere, pa iu referuar transformimit, porvetëm proçedurës për themelimin e një shoqërie tregtare të re sipas legjislacionit tregtar.

5. Bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit, si dhe çdo të drejtë/detyrim që rrjedh prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe ish-njësive të qeverisjes vendore me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me shoqëritë kontraktuese.

Ajo çka rregullon në pikën 5 kjo VKM është në parim se çdo e drejtë dhe detyrim ekzistues, që rezulton nga aktiviteti I deritanishëm I shoqërive të UK, apo Shoqërive të UK , apo çfarëdo forme juridike tregtare, do të mbartet në shoqëritë aksionere të riorganizuara në përputhje me ndarjen e re administrative - territoriale. Në këtë kontekst VKM përfshin Këshillin e Ministrave, Ministrinë, institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqëritë kontraktuese.

6. Në rastet kur në dy ose më shumë bashki ekziston vullneti i përbashkët për krijimin e një shoqërie të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., të përbashkët, në bazë të nevojave për këtë bashkim e të studimit përkatës, ato do të mbështeten me investime nga qeverisja qendrore.

Referuar praktikave të mbështetjes me investime të njërive të pushtetit vendor nga qeverisja qendrore evidentohet fakti se fizibiliteti i tyre (investimeve) rritet ndjeshëm kur kemi një studim të mireargumentuar si dhe numër të konsiderueshëm konsumatorësh, çka do të thotë se mbështetja me fonde është më efektive dhe përkthehet në rezultate të prekshme në shërbimet që ofrojnë shoqëritë UK kur dy ose më shumë njësi administrative krijojnë një shoqëri UK. Në aspektin tregtar do të kemi bashkim të shoqërive e cila kryhet në përputhje me ligjin nr.9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.

7. Në rastet kur një shoqëri e ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., ekzistuese, mbulon me shërbim më shumë se një bashki apo në rastin e parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, organet themeluese të Shoqërisë përbëhen nga përfaqësuesit e bashkive përkatëse, pesha e vendimmarrjes të të cilëve është në raport të drejtë me përqindjen e aksioneve që disponon secila bashki. Këshillat bashkiakë përkatës bëjnë miratimin e përqindjeve takuese të aksioneve sipas pikës 3, të këtij vendimi, dhe organet e Shoqërisë bëjnë regjistrimin e aksioneve sipas legjislacionit në fuqi.

Në pikën 7 Këshilli i Ministrave ka rregulluar mënyrën e ndarjes së përqindjeve të zotërimit të aksioneve në rastin kur një shoqëri UK mbulon me shërbim më shumë se një Bashki. Parimi rregullator i shprehur përmes pikës 7 është ai i proporcionalitetit kundrejt totalit të kapitalit të Shoqërisë. Në përputhje me këtë parim Bashkitë marrin në zotërim përqindje aksionesh sipas kontributit të kapitaleve të destinuara për t'i përfshirë në shoqëri.

8. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., kanë detyrimin të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve dhe prefektit të qarkut për të gjitha të dhënat dhe informacionet sipas formateve e afateve të përcaktuara prej saj. Formatet e dhënies së informacionit miratohen me udhëzime të ministrit të linjës. Gjithashtu, shoqëritë kanë detyrimin për të raportuar për pjesën e tyre të të dhënave që duhet të hidhen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

DPUK në sajë të bashkëpunimit të ngushtë me sha uk administron informacion të detajuar, sipas vetëdeklarimit të sha UK-ve, për 300 të dhëna, si dhe përpunon 60 tregues performance.

Drejtoria e monitorimit dhe benchmarking në DPUK tashmë do të administrojë këto të dhëna edhe në mënyrë elektronike.

Formati i deklarimit dhe mënyra e raportimit do të formalizohen me ane të udhëzimit të ministrit të linjës (MTI), në mënyrë që të garantohet raportim i standardizuar dhe brenda afateve që do të përcaktohen në këtë udhëzim.

Me krijimin e Agjencisë Kombëtare të UK, do të formalizohet edhe kompetenca e kësaj agjencie për të kontrolluar korrektësinë e raportimit, në mënyrë që vendimmarrja e politikëbërjes të mbështetet në të dhëna të kontrolluara dhe certifikuar.

Nga ana tjetër sha UK dhe njësitë e qeverisjes vendore duhet të raportojnë edhe mbi informacionet që do të kërkohen në kuadër të krijimit të Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujerave MBZHRAU.

9. Ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve, në planifikimin e fondeve për investime nga buxheti i shtetit dhe institucionet financiare ndërkombëtare udhëhiqet nga dokumentet strategjike sektoriale të miratuara si dhe nga performanca e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a.

MTI synon të formalizojë, duke parashikua në këtë pike të VKM detyrimin e Qeverisë Qendrore për të planifikuar investimet në mënyrë transparente dhe në bazë të dokumenteve strategjike

Masterplani Kombëtar (i financuar nga KfW), tashmë i miratuar edhe në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Ujit (Dhjetor 2015), është një instrument që garanton planifikimin e investimeve sipas një metodologjie prioritizimi të përcaktuar, të njohur nga të gjithë aktoret dhe tashmë të detyrueshme për zbatim.

Nga ana tjetër, duke vlerësuar shoqëritë që performojnë, si dhe duke patur parasysh nxitjen që të gjithë sha UK të performojnë në maksimumin objektiv të situatës së tyre teknike/ financiare, qeveria shqiptare ka parashikuar një qasje të re, duke bërë të mundur që shoqëritë që arrijnë kriteret e rena dakord midis paleve, të përfitojnë investime nga granti i performancës.

10. Stafi menaxherial dhe operacional i shoqërive ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., i nënshtrohet procesit të trajnimit dhe certifikimit sipas programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve.

Me anë të këtijparashikimi, MTI i ka hapur rrugën formalizimit të programit kombëtar të trajnimit dhe certifikimit të stafeve operationale dhe menaxheriale të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve. Ky program pritet të formalizohet brenda vitit 2016 dhe do të bëjë të mundur që separi, tëgarantohet cilësia e stafeve që administrojnë një shërbim jetik për qytetaret; se dyti, tëgarantohet vazhdimësia e stafeve dhe se treti, duke formalizuar këtë proces garantojmë që punësimet në sha UK do të bëhenvetëm brenda grupit të punonjësve/individëve që janë të pajisur me këtë certifikate.

Gjithashtu ngjitja nga një kategori në një tjetër, do të bëhet e mundur pas plotësimit të kriterëve që do të detajohen në vijim, si dhe pas marrjes së certifikimit përkatës. Kjo qasje do të garantojë shërbim cilësor për qytetaret.

Ky proces mbështet nga USAID si dhe përfshin të gjithë aktoret e sektorit. Rol të rëndësishëm ka edhe grupi këshillimor i përbërë nga drejtuesit e sha UK tipike (Tirana, Kamza, Lezha, Berat-Kuçova, Durrës dhe Vau i Dejës).

## **KREU II**

### **DISPOZITA KALIMTARE**

#### **E TË FUNDIT**

1. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., organizohen në përputhje me statutin tip, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ligji nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” parashikon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të një shoqërie aksionere. Në tërësinë e formulimeve të dhëna nga ky ligj, pika 1 e kreut II nëkësaj VKM-je, ka përcaktuar çka duhet të përmbajë statuti tip i shoqërive UK. Bashkitë zotëruese të kapitalit të shoqërive aksionere të UK do të duhet të ndryshojnë statutet e tyre ekzistuese në përputhje me statutin tip. Referencat ligjore për të kryer këto ndryshime janë tek Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar si dhe ligji i lartpërmendur për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Të gjitha bashkitë dhe shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, bëjnë zgjerimin dhe zvogëlimin e kapitalit, sipas rastit, duke shtuar ose hequr kapitalet e sistemeve publike të ujësjellës-kanalizimeve që i bashkohen ose që i hiqen.

Reforma administrativo – territoriale ka sjellë si pasojë detyrimin për riorganizimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Shërbimet ekzistuese që ushtrojnë këtë aktivite në formën e shoqërive aksionere mund të ndodhen eventualisht në situatën e mbetjes së pjesëve të tyre të kapitalit jashtë ndarjes së re territoriale të Bashkisë, apo pjesë të kapitalit të tyre duhet t'i transferohen një Bashkie tjetër. Kjo situatë në kontekstin e së drejtës tregtare ka të bëjë me zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë aksionere UK. Si rregull Bashkia së cilës i kanë mbetur pjesë të kapitalit jashtë juridiksionit të territorit të saj, duhet të ndërmarri procedurën e zvogëlimit të kapitalit përmes thirrjes së mbledhjes së asamblesë. Ndërsa Bashkia që ka përfituar pjesë të mbetur do të ndërmarri procedurën e zmadhimit të kapitalit. Gjithsesi rastet konkrete tipike do t'i japim të shpjguara më poshtë.

3. Të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., brenda 3 (tre) muajve nga riorganizimi, aplikojnë për t'u pajisur me licencë për kategoritë përkatëse të shërbimeve dhe për rishikim të tarifave pranë ERRU-së.

Kjo pikë nuk ka nevojë për shpjegime.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007, “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësite të qeverisjes vendore”, nr.677, datë 3.10.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.642, datë 11.10.2005, të Këshillit të Ministrave “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore””, nr.678, datë 3.10.2007, “Për një shtesë në vendimin nr.271, datë 9.5.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore””, shfuqizohen.

Kjo pikë nuk ka nevojë për shpjegime.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Enti Rregullator i Ujit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimive, Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, njësitë e qeverisjes vendore, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, sh..a., për zbatimin e këtij vendimi.

Kjo pikë nuk ka nevojë për shpjegime.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

# STATUTI TIP I SHOQËRIVE AKSIONARE, SHTETËRORE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEV

## STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE " \_\_\_\_\_ "

### Neni 1

#### Emërtimi dhe Selia

1. Shoqëria aksionere ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë/bashkive \_\_\_\_\_, aksionerë të saj.
2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet Sh.A Ujësjiellës Kanalizime \_\_\_\_\_.
3. Selia e Shoqërisë është në adresën \_\_\_\_\_.

Pika 1 dhe Pika 2 e këtij neni janë të ndara në përcaktimet që shprehin: Pika 1 kuptohet si përcaktim i faktit që një shoqëri aksionere UK e ushtron veprimtarinë brenda zonës së juridiksionit të një bashkie. Një shoqëri aksionere UK mund të ushtrojë gjithashtu veprimtarinë e saj në më shumë se një territor bashkie. Në këtë rast kapitali i Shoqërisë do të zotërohet nga më shumë se një bashki (aksionerë).

### Neni 2

#### Objekti

1. Objekti i Shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" është:
  - a. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
  - b. Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
  - c. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
  - d. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
  - e. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
2. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, liçencat sipas legjislacionit në fuqi.

Mundëson që çdo sha UK të ofrojë tashmë edhe shërbimin e ujësjiellës dhe atë të kanalizimeve (aktualisht disa prej shauk ofrojnë vetëm shërbimin e ujësjiellës), si dhe të tarjitimit të ujërave të ndotura në raste ku ka impiante.

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën \_\_\_\_ lekë. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar tërësisht.
2. Kontributet e aksionarit janë kontribute në natyrë, të cilat janë vlerësuar përpara regjistrimit të Shoqërisë nga një ekspert i caktuar nga gjykata kompetente, vlerësim i cili është materializuar në një raport vlerësimi që përmban një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë.

1. Kapitali i nënshkruar - Referenca është me nenin 113 të Ligji 9901“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ku në pikën 2 të këtij neni përcaktohet se aksionet e nënshkruara me kontribute në natyrë duhet të kalohen tërësisht përpara regjistrimi, që kupton vënien e kësaj pasurie në natyrë tërësisht në favor të Shoqërisë në krijim e sipër.
2. Eksperti Kontabel i licencuar (person fizik ose juridik), i caktuar nga gjykata, (sipas rastit edhe Vlerësues pasurive të paluajtshme) do të kryejë procedurën e caktimit të vlerës në Lek të të gjitha pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të Shoqërisë, duke shpjeguar përmes një raporti të vlerësimit metodat e vlerësimit që janë zbatuar, vlerën e përlogarit. Ky raport është pjesë përbërëse e dokumentave që dorëzohen në QKR në rastin e aplikimit për regjistrimin e Shoqërisë.

#### **Neni 4**

##### **Aksionet e Shoqërisë**

1. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e Shoqërisë.
3. Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga një kuotë me vlerë \_\_\_\_ lekë dhe zotërohet në masën -----% nga aksionari.

1. Pika 1 përcakton formën e aksionit, në rastin tonë nominative cakton një vlerë nominative, siç përcaktohet në pikën 3), e cila pjesëton vlerën e kapitalit themeltar duke nxjerrë numrin e aksioneve të Shoqërisë. Në këtë pikë përcaktohet gjithashtu se nuk kemi privatizim të kapitalit të Shoqërisë UK.
2. Referuar ligjit për shoqëritë tregtare vetë shoqëria (këshilli i administrimit) harton dhe plotëson formatin standard të regjistrit të aksioneve.



## Neni 5

### Organet e Shoqërisë

1. Organet e Sh.A. Ujësjiellës Kanalizime janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme.
- b. Këshilli i Administrimit

|                                       |
|---------------------------------------|
| Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime. |
|---------------------------------------|

## Neni 6

### Asambleja e Përgjithshme (AP)

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga kryetari i bashkisë përkatës, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
2. Nëse shoqëria aksionere mbulon me shërbim më shumë se një bashki, AP përbëhet nga kryetarët e bashkive përkatëse. Pesha e votës e secilit prej anëtarëve të AP është në përpjestim me përqindjen e aksioneve, sipas ndarjes territorial administrative.
3. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e Shoqërisë. Ajo thirret nga Kryetari i AP, Këshilli i Administrimit, administratori i Shoqërisë. Ajo mund të thirret gjithashtu nga:
  - a. eksperti kontabël i autorizuar,
  - b. nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent, ose
  - c. me kërkesë të aksionerit të vetëm të Shoqërisë.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.
4. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore dhe që i dërgohet me anë të një njoftimi me letër rekomande çdo anëtar të Asamblesë së Përgjithshme me shpenzimet e Shoqërisë.
5. Njoftimi, që duhet t'i shkojë çdo anëtar të Asamblesë së Përgjithshme apo të njihet prej çdo anëtar të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, përcakton ditën, orën dhe vendin ku bëhet mbledhja, natyrën e mbledhjes dhe rendin e ditës.
6. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme që thirret në mënyrë të parregullt është absolutisht i pavlefshëm. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas procedurës së kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime

të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 6 parashikon menyren e organizimit dhe të thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme të aksionereve në përputhje me Legjislacionin tregtar dhe TAR.

## **Neni 7**

### **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme (AP)**

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
  - a. përcakton politikat tregtare të Shoqërisë si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe treguesit të punës, të rënë dakord midis palëve kontraktore;
  - b. miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
  - c. miraton draft planin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit
  - d. emëron dhe shkarkon ekspertët kontabël të autorizuar;
  - e. vendos mbi zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
  - f. çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe në statut.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nga pika 1.a kuptohet se kontrata e menaxhimit nënkupton “kontratën e performancës”, që përmendet më tej në nenin 11.2, mes Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit të Administrimit të Shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë së Përgjithshme**

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga kryetari i bashkisë përkatëse. Në rast se AP përbëhet nga më shumë se një aksioner, aksionerët zgjedhin kryetarin e AP.
2. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme asistohet nga një sekretar i emëruar nga AP, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon Kryetari i AP.

3. Proçesverbali i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e AP tregon datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e drejtuesit dhe sekretarit të AP, kuorumin e arritur dhe numrin e aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e AP, një përmbledhje të diskutimeve, tekstin e vendimeve të kaluara për votim dhe rezultatin e votimit. Proçesverbali firmoset nga të gjithë pjesëmarrësit e AP në mbledhje si dhe nga sekretari.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 9**

### **Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet nga personi i cili bën lajmërimin.
2. Në rast se mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së saj nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 10**

### **Kuorumi dhe marrja e vendimeve**

1. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
  - a. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b. Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
  - c. Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
  - d. Vendimet për investime;
  - e. Riorganizimi i Shoqërisë.
2. Në rastin kur AP ka më shumë se një aksioner, në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 30% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, me përjashtim të rastit kur AP vendos për shkarkimin e administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ku nuk

kërkohej ky kuorum.

3. Kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, sipas pikës 4 të kësaj dispozite, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 50% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme.
4. Asambleja e Përgjithshme merr vendim me 3/4 (tre të katërtat) e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 3 të kësaj dispozite, lidhur me:
  - a. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar.
  - b. Riorganizimin e Shoqërisë.
5. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në ligj dhe në pikën 4 të kësaj dispozite, çdo vendim tjetër i Asamblesë së Përgjithshme merret me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 2 të kësaj dispozite.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 11**

### **Këshilli i Administrimit (KA)**

1. Këshilli i Administrimit është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikqyrje të veprimtarisë së Shoqërisë.
2. Kohëzgjatja e funksionit të Këshillit të Administrimit është 3 vjet Mandati i KA ndërpritet në rast konstatimi të mospërbushjes së objektivave të vendosura në kontratën e performancës midis AP dhe anëtarëve të KA sipas legjislacionit në fuqi.
3. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Administrimit mbeten vakant, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga mbetja vakant e vendit. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.
4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1(një) Këshill Administrimi të shoqërive aksionare që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Këshilli i Administrimit zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata ushtrojnë këtë funksion për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm. Këshilli i Administrimit mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën sipas legjislacionit në fuqi

6. Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Këshillit të Administrimit drejtohen nga zëvendëskryetari.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 12**

### **Përbërja e Këshillit të Administrimit**

1. Anëtarët e Këshillit Administrimit janë persona fizikë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat (3) vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Ata duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a. Të jenë me profesion inxhinier të fushës, ekonomist ose jurist.
  - b. Të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5(pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë.Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm.
2. Këshilli Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) prej të cilëve është Administratori dhe 2 (dy) janë persona të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.
3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit, lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar ndër të tjera, kriteret e qarta performance që pritet të arrijë anëtarët e Këshillit të Administrimit në terma vjetor. Objektivat mbi performancën (indikatorët) e vendosura në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznes planet e Shoqërisë.
4. Në rastin e vendeve vakante, që krijohen me vdekjen apo dorëheqjen e një apo disa anëtarëve të Këshillit Administrimit, kur numri i anëtarëve të Këshillit Administrimit ka zbritur nën minimumin ligjor, Administratorët duhet të thërrasin urgjentisht mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## Neni 13

### Kompetencat e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së Shoqërisë dhe i jep administratorit autorizimin për kryerjen e veprimeve që nuk mund të kryhen prej tij pa autorizimin e Këshillit të Administrimit.
2. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.
3. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
  - a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë.
  - b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë nga administratori.
  - c) Të gjykojë paraprakisht biznesplanin e Shoqërisë e paraqitur nga Administratori, Ky dokument duhet të miratohet dhe nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit, për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme për miratim.
  - d) Të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë.
  - e) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë.
  - f) Të respektojë standardet e kontabilitetit;
  - g) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë.
  - gj) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar.
  - h) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administratorëve. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në shkronjën "gj" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

- i) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
  - j) Të miratojë paraprakisht biznes planin e paraqitur nga Administratori dhe t`ja paraqesë për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme.
4. Këshilli i Administrimit ka të drejtë t`i propozojë Asamblesë së Përgjithshme:
- a. Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate të Shoqërisë.
  - b. Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së Administratorëve të Shoqërisë.
  - c. Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë.
  - d. Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
  - e. Për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Në pikën 3/c të këtij neni është përdorur neni “të gjykojë”, që mund të kuptohet si shqyrtim dhe vlerësim të dokumentit të biznes planit të Shoqërisë. Pas këtij procesi në pikën 3/j është përdorur termi “të miratojë” paraprakisht biznes planin, që nënkupton marrjen e një vendimi për t`ja paraqitur Asamblesë.

## **Neni 14**

### **Mbledhja dhe Vendimet e Këshillit të Administrimit**

1. Këshilli i Administrimit mbledhet jo më pak se njëherë në muaj muaj dhe sa herë e kërkon interesi i Shoqërisë aksionere, me thirrjen e kryetarit.
2. Kryetari, duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur Administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit, i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.
3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin e Administrimit duke i përcaktuar rendin e ditës.
4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.

5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit të Administrimit duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.
7. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.
8. Vendimet e Këshillit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit të Administrimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 15**

### **Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë KA ose një anëtar të saj, duke vërtetuar mospërmbushjen e objektivave të vendosura në kontratën midis palëve, me shumicë të thjeshtë votash.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 16**

### **Përfundimi i Mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit**

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme:
  - a. Me mbarimin e Mandatit të Administratorit.
  - b. Me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 17**

### **Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit**

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.



2. Shoqëria njih gjithashtu dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit të Administrimit, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Administrimit për probleme të Shoqërisë.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 18**

### **Administratori i Shoqërisë**

1. Administratori i Shoqërisë është person fizik, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të Shoqërisë. Për t'u zgjedhur Administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
  - a. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master Shkencor”, në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e administrimit të biznesit, sipas profilit që do të emërohet.
  - b. Të zotërojë çertifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës – kanalizimeve - trajtimin e ujrave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe çertifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të sha uk-ve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë çertifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet çertifikatën sapo çertifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me çertifikatën përkatëse të kualifikimit, përbën shkak për shkarkimin e tij.
  - c. Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate positive të punës të vërtetuar me referenca nga punëdhënësitë mëparshëm.
3. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.
4. Një person nuk mund të emërohet Administrator në më shumë se një shoqëri.
5. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por mbi bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe Administratorit do të jetë vjetor mbi bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar.
6. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për Administratorin sipas kriterëve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe Administratorit.

7. Administratori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

- a. Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e Shoqërisë nëpërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- b. Harton planbizneset e Shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Administrimit
- c. Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura e organizimit të Shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtori/departament teknik dhe një drejtori/departament tregtar, drejtuesit e të cilëve zgjidhen nga Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas nenit 19 dhe 20 të këtij statuti.
- d. I paraqet Këshillit të Administrimit një raport të njëherë në muaj mbi ecurinë e Shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, Administratori duhet t'i paraqesin Këshillit të Administrimit llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.
- e. Përfaqëson dhe vepron në emër të Shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj.
- f. Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- g. Raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë
- h. Lidh kontrata në emër të Shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtoresve të tjerë.
- i. Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së Shoqërisë.
- j. Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme të detyrueshme për menaxhimin administrativ dhe financiar të Shoqërisë.
- k. Organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të Shoqërisë.
- l. Krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë.
- m. Kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe ligjeve të tjera në fuqi.
- n. Paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit Administrativ, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së Shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet.
- o. Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit.

- p. Drejton veprimtarinë e Shoqërisë zgjedh dhe mbikqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e Shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

Duhet të kuptohet se Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar të përparojë në drejtimin që përzgjedhja, punësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të personelit në sektorin e ujit do të bazohet në një program gjithëpërfshirës trajnimesh dhe certifikimit me teste të kërkesave si parakusht për punësim. Deri sa të jetë zbatuar plotësisht ky program trajnimi dhe certifikim me test, Ministria rezervon të drejtën të japë çertifikatatë përkohshme të stafit të caktuar që janë emëruar në një Shoqëri në pozicione që kërkojnë certifikim.

## **Neni 19**

### **Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e Drejtorit Teknik**

1. Drejtori Teknik zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:
  - a. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master Shkencor”, në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme, si dhe pervojë pune jo më pak se 3 vjet.
  - b. Në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme.
  - c. Të zotërojë çertifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës – kanalizimeve - trajtimin e ujrave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të sha uk-ve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë çertifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet çertifikatën sapo çertifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me çertifikatën përkatëse të kualifikimit, përbën shkak për shkarkimin e tij.
  - d. Drejtori Teknik ka këto kompetenca:
    - (i) Studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të kosumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.
    - (ii) Përditësim e rjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura.

- (iii) Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.
- (iv) Administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesore, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe paisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale).
- (v) Sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standarteve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri të konsumatori.
- (vi) Garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.
- (vii) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm

|                                       |
|---------------------------------------|
| Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime. |
|---------------------------------------|

## **Neni 20**

### **Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e Drejtorit Tregtar**

1. Drejtori Tregtar zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:
  - a. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master Shkencor”, në shkencat ekonomike, në degët finance/administrim biznesi.
  - b. Të zotërojë çertifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë.
2. Drejtori Tregtar ka këto kompetenca::
  - a. Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore, për të gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare të Shoqërisë.
  - b. Siguron zbatimin e praktikave dhe procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e Shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj.
  - c. Harton plan-buxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.
  - d. Drejtori Tregtar është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat ia paraqet për miratim paraprak Administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqitet i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit.

- e. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- f. Ushtron kontrole periodike mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës.
- g. Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga Ministria e Financave.
- h. Siguron zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë.
- i. Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të Shoqërisë
- j. Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm

Deri sa të jetë zbatuar plotësisht një program trajnimi dhe certifikimi me testim, Ministria rezervon të drejtën të japë certifikata të përkohshme stafit të caktuar që emërohet në këtë pozicion.

## **Neni 21**

### **Detyrimi i besnikërisë**

1. Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:
  - a. Të kryejë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë.
  - b. Të ushtrojnë kompetencat, që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita.
  - c. Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim.
  - d. Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ata të Shoqërisë.
  - e. Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e Shoqërisë tregtare.
3. Administratorët, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të kësaj dispozite, janë të detyruar t'i shpërblejnë Shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 22**

### **Shkarkimi i Administratorit**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë, Administratorin, me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërmbushjes së objektivave të kontratës midis palëve.
2. Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë shkarkimin e Administratorit brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tyre, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 23**

### **Përfundimi i Mandatit të Administratorit**

1. Mandati i Administratorit të Shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 24**

### **Ekspertët kontabël të autorizuar**

1. Kontrolli i Shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 25**

### **Ushtrimi kontabël**

1. Ushtrimi kontabël fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 26**

### **Inventari-Llogaritë vjetore**

1. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore.

2. Njësitë ekonomike, të Shoqërisë duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse.

Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.

3. Administratori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e Shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 27**

### **Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit**

1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.
2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Parimisht zotëruesi i kapitalit të Shoqërisë (Bashkia) ka të drejtën për të vendosur mbi përdorimin e vlerave të akumuluarra përtej rezervës ligjore 10%. Megjithatë, pavarësisht nga përcaktimi në statut, bashkia e ka të drejtën që këtë vlerë ta përdorë. Çështja e ndryshimi të tarifës të ujit është jo vetëm tregues i performancës së Shoqërisë, por edhe aspekt vendimarrës politik i bashkisë në perputhje me përcaktimet që rrjedhin nga aktet e ERRU.

## **Neni 28**

### **Procedura e bashkimit të Shoqërisë me operatorë të tjerë**

1. Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a. Të jenë të licensuar nga Enti Rregullator i Ujit.
  - b. Të kenë vlerësuar dhe azhornuar inventarin e aseteve dhe të likuiditeteve të tyre.
  - c. Të jetë miratuar me vendim përkatës të Këshillave Bashkiak.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 29**

### **Likuidimi i Shoqërisë**

1. Likuidimi i Shoqërisë do të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.

## **Neni 30**

### **Dispozita të kalimtare**

1. Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e Shoqërisë, do të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

Kjo pikë nuk ka nevojë për Shpjegime.



### **3. ÇËSHTJE QË DUHEN TË MERREN PARASYSH DHE SHQYRTOHEN NË PROCESIN E HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË PLANIT TË TRANZICIONIT**

#### **3.1. HYRJE**

##### **3.1.1 Qëllimi i Planit të Tranzicionit**

Qëllimi i përgatitjes së planit të tranzicionit është t'i ofrojë Bashkisë një metodë të strukturuar për trajtimin e çështjeve, ndryshimeve, ndikimeve dhe vendimeve që duhet të merren parasysh menjëherë për kalimin drejt riorganizimit për sigurimin e shërbimit ujësjellës-kanalizime, nën dritën e Reformës Administrative-Territoriale, që u realizua nëpërmjet legjislacionit të miratuar nga Parlamenti (Ligji nr. \_\_\_\_\_ " \_\_\_\_\_", datë \_\_\_\_\_) dhe më vonë edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave që u miratua për reformën në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

##### **3.1.2 Ndikimi i Reformës Administrative-Territoriale**

Reforma Administrative-Territoriale (RAT) ishte faktikisht një vendim i madh i politikës për shkrirjen e njësive të qeverisjes vendore nga 371 bashki dhe komuna, secila me organet e veta administrative të qeverisjes, në aktualisht 61 bashki që mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Edhe pse ishte një nismë e madhe, me ndikime të rëndësishme qeverisëse për sa i përket ristrukturimit dhe administrimit të këtyre njësive të reja vendore, reforma nuk ndryshoi natyrën e "shërbimeve të veta" të sigurimit të shërbimit ujësjellës-kanalizime, duke qenë se këto shërbime vazhdojnë të jenë kompetencë dhe përgjegjësi e vetme e qeverisë vendore.

Ajo që ka bërë reforma është krijimi i sfidave për këto 61 bashki të reja që tashmë duhet të merren me sigurimin e këtyre shërbimeve thelbësore publike në veçanti në një sipërfaqe shumë më të madhe gjeografike dhe me një popullsi rurale më të shpërndarë, pasi shërbimi i licencuar ujësjellës-kanalizime (58 në total) ishin më tepër të përqendruar rreth zonave urbane dhe periferike me dendësi të lartë popullore.

##### **3.1.3 Ndikimi i Reformës në Sektorin e Ujësjellës-Kanalizimeve**

Ndikimi i reformës së sektorit ujësjellës-kanalizimeve në ofrimin e shërbimit ujësjellës-kanalizime është shumë i përqendruar në evidentimin e kompetencave, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Para reformës administrative-territoriale dhe reformave në sektorin UK, njësitë e qeverisjes vendore, në pjesën më të madhe, ishin pronarë pasiv në ushtrimin e rolit të tyre të "shërbimeve të veta". Në shumë raste, Shoqëritë e privatizuara ujësjellës-kanalizimeve (Sh.a.), me këshillat e tyre mbikëqyrës, kanë vepruar deri diku të pavarur nga administrata e pushtetit vendor, me këshillat mbikëqyrës dhe për pasojë drejtorët e këtyre Shoqërive jo gjithmonë përgjigjeshin direkt për veprimet dhe punën e tyre.

Me reformat në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, kryetari i bashkisë (ose kryetarët nëse Shoqëria ujësjellës-kanalizimet është në pronësi dhe shërben në më shumë se një bashki) do të ketë shumë më tepër autoritet mbikëqyrës për administrimin e Shoqërisë.

Përveç kësaj, reformat e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve e bëjnë të qartë se Shoqëritë e reja UK që do të krijohen nga RAT dhe reforma e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve duhet të menaxhohen duke aplikuar praktika të shëndetshme biznesi. Për këtë arsye, të gjitha Shoqëritë UK do të krijohen si shoqëri aksionere sipas Ligjit për Sipërmarrjen dhe Shoqëritë Tregtare. Për të bërë të qarte dhe për të siguruar se kompetencat, përgjegjësia dhe llogaridhënia kuptohen siç duhet, reformat përfshijnë edhe një shtojcë që ofron një tip për një statut të ri që duhet të miratohet, pasi të ketë përfunduar ri-organizimi i Shoqërisë.

### **3.1.4 Struktura e Planit të Tranzicionit**

Struktura e planit të tranzicionit është shumë e drejtpërdrejtë në trajtimin e zonave funksionale me interes në organizimin dhe menaxhimin e Shoqërisë ujësjellës-kanalizimeve. Në këtë udhëzues, struktura e planit të tranzicionit dhe çështjet që do të merren parasysh dhe do të trajtohen në çdo fushë funksionale paraqiten në mënyrë të atillë që ata të diskutojë për kushtet e ndryshme që mund të ekzistojnë, edhe pse dihet se jo të gjitha kushtet ekzistojnë tek të gjitha bashkitë.

Në mënyrë të veçantë, Plani i Tranzicionit duhet të trajtojë, të paktën, fushat/çështjet funksionale të mëposhtme, pasi ato kanë të bëjnë me veprimet që duhet të marrë parasysh Bashkia kur të marrë masa të menjëhershme për riorganizimin e shërbimit ujësjellës-kanalizime në këtë fushë administrative si rezultat i reformës administrative-territoriale dhe reformave të sektorit UK.

- Institucionale
- Burimet Njerëzore dhe Struktura Funksionale
- Teknike dhe Operacionale
- Shërbimi ndaj Klientit
- Rregullues

## **3.2. PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I REFORMAVE PËR SEKTORIN UJËSJELLËS-KANALIZIME PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME**

### **3.2.1 Përmbledhje**

Reformat e sektorit UK shqyrtohen më hollësisht në kreun 2 të këtij udhëzusi me komente që jepen sa herë që është nevoja për një përgjigje të mundshme për pyetje që mund të adresohen në lidhje me gjuhën e neneve të reformave. Kjo është bërë edhe për statutin tip, i cili jepet si shtojcë e vendimit të reformës në sektorin UK.

### **3.2.2 Ndikimi i Vendimit të Reformës në Sektorin e Ujësjetllës-Kanalizimeve**

Ky nënkaptull ka për qëllim vetëm të tërheqë vëmendje të posaçme tek nenet e Vendimit të Reformës në Sektorin Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Statutit tip të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vlerësimet që do të bëhen në lidhje me përgatitjen e një plani tranzicioni.

- Sigurimi i shërbimeve ujësjetllës-kanalizimeve duhet të jetë në përputhje me kufijtë administrative- territoriale sipas Reformës së Re Administrative-Territoriale
- Të gjitha shërbimet që do të ofrohen nga Shoqëritë në pronësi publike, do të ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve.
- Stafi dhe drejtuesit operacionalë të Shoqërive UK do t'i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit të aprovuar nga ministria e linjës.
- Të gjithë Shoqëritë do të ri-organizohen në bazë të VKM dhe do të miratojnë statutin e ri duke përdorur statutin tip të VKM.
- Statuti tip i ri përcakton strukturën e menaxhimit me një nivel administrimi me dy anëtarë të jashtëm, të emëruar të Bordit të Administrimit plus Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë UK.
- Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë UK punëson Drejtorin Teknik dhe Drejtorin Financiar të Shoqërisë.
- Kryetari i Bashkisë shërben edhe si aksioner i asamblesë dhe është kryetari i saj.
- Bordi Drejtues nënshkruan një kontratë performance me asamblesë e përgjithshme (Kryetarin e Bashkisë).

## **3.3. ASPEKTE INSTITUCIONALE**

### **3.3.1 Përmbledhje**

Në pjesën më të madhe të bashkive të reja, zona administrative e bashkisë ka të ngjarë të ketë pasur shërbim të pjesshëm nga Shoqëria UK e licencuar, me pjesën e mbetur të zonës administrative që shërbehet ose nga strukturat formale të komunës ose që nuk kishte fare shërbim. Përveç kësaj, mund të kenë ndodhur edhe situatat e mëposhtme:

- Rasti 1: Bashkia e Re ka të përfshirë ish Bashkinë dhe ish Komunat të cilat së bashku janë zotëruese të kapitalit të Sha UK.
- Rasti 2: Bashkia 1 ka të përfshirë ish Komuna që zotërojnë % kapitali të një Sha UK e cila i përket Bashkisë 2.
- Rasti 3: Bashkia e Re ka të përfshirë Komuna me sisteme UK të paorganizuar në formën e një njësie ekonomike.
- Rasti 4: Bashkia e Re ka dy ish Bashki, respektivisht dy Sha UK.

Rasti 5: Bashkia e Re nuk ka trashëguar Sha UK.

Rasti 6: Bashkia e Re nuk ka organizim të shërbimit UK sipas ligjit të shoqërive tregtare, por si ndërmarrje UK ose U.

Nënkapitujt e mëposhtëm shërbejnë për të trajtuar situata të ndryshme të listuara më sipër me rekomandimet që duhet të merren parasysh nga zyrtarët vendorë për hartimin e planit të tranzicionit. Duhet theksuar se rekomandimet mbështeten në praktikën më të mirë. Megjithatë, vendimi përfundimtar i takon bashkisë, për sa kohë që vendimi përfundimtar i saj është në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi.

**Rasti 1: Bashkia e Re ka të përfshirë ish Bashkinë dhe ish Komunat të cilat së bashku janë zotëruese të kapitalit të Sha UK.**

Në ndarjen e re administrative – territoriale kemi të përfshirë bashkinë dhe komunat e mëparshme, të cilat së bashku kanë qenë zotëruese të kapitalit të Sha UK. Në këtë rast gjendja ekzistuese e zotërimit të kapitalit duhet të ndryshojë nga zotërimi i përbashkët i bashkive dhe komunave sipas organizimit të mëparshëm administrativ – territorial, në zotërim 100% të kapitalit të Sha UK nga bashkia e re. Veprimi juridik në këtë rast konsiston në mbledhjen e asamblesë së bashkisë, me rend dite ndryshimin e nenit të statutit, që ka të bëjë me ndryshimin e aksionerëve që zotërojnë kapitalin. Për shkak se këto komuna nuk ekzistojnë më dhe pjesa e kapitalit në administrim të tyre tanimë është pjesë e bashkisë së re të krijuar, për shkak të ligjit, këshilli bashkiak i bashkisë së re vendos për kalimin 100% të kapitalit të Sha UK në pronësi të bashkisë.

Veprimi i sugjeruar është të kryhet thirrja e mbledhjes së asamblesës për ndryshimin e statutit sa i takon nenit përzotëruesit e aksionerëve shoqërisë.

Formati i përdorur në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit është për ndryshimet statutores.

**Rasti 2: Bashkia 1 ka të përfshirë ish Komuna që zotërojnë % kapitali të një Sha UK e cila i përket Bashkisë 2.**

Si pasojë e reformës administrative-territoriale, Bashkia(1) e re ka në territorin e saj administrativ komuna që zotërojnë përqindje kapitali të një shoqërie aksionere UK që i përket një bashkie(2) tjetër. Bashkia (2) duhet të kryejë procedurën e zvogëlimit të kapitalit pasi komuna nuk është me pjesë e saj ndërsa Bashkia(1) duhet të kryejë procedurën e zmadhimit të kapitalit.

Dokumentacioni në këtë rast do të hartohet në përputhje me formularin e ndryshimit të kapitalit në shoqëritë aksionere të QKR.

**Rasti 3: Bashkia e Re ka të përfshirë Komuna me sisteme UK të paorganizuar në formën e një njësie ekonomike.**

Në ndarjen e re administrativo – territoriale, kemi të përfshirë komuna të mëparshme, të cilat kanë sisteme të UK të paorganizuar në formën e një njësie ekonomike (shoqëri tregtare apo ndërmarrje). Në këtë rast duhet të kryhet inventarizimi i sistemeve të UK të këtyre komunave, vlerësimi i tyre, me qëllim përfshirjen përmes procedurës së zmadhimit të kapitalit tek ShA UK e bashkisë së krijuar.

Procedura e zmadhimit të kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së përgjithshme e cila cakton ekspertin kontabël të miratuar nga gjykata përpërgatitjen e raportit për zmadhimin e kapitalit.

Dokumentacioni i hartuar do të formësohet në përputhje me standardin (formularët) e kërkuar nga QKR për efekt depozitimi.

**Rasti 4: Bashkia e Re ka dy ish Bashki, respektivisht dy Sha UK.**

Në ndarjen e re administrativo – territoriale bëjnë pjesë dy bashki të mëparshme. Në këtë rast do të kryhet bashkimi i të dy ShA UK të bashkive respektive në një ShA UK të vetme. Procedurat e bashkimit mund të kryhen në formën e bashkimit të dy shoqërive duke krijuar njëshoqëri të re, por edhe në formën e transferimit të plote të kapitalit të njëresshoqëri tek tjetra. Në këtë rast do të kemi çregjistrimin e njëshoqërie dhe zmadhimin e kapitalit të shoqërisëpërfituese. Kjo mënyrë është me përshtatshme në kushtet e riorganizimit të UK dhe me kohe me të shkurtër ekzekutimi.

Procedura e zmadhimit të kapitalit do të kryhet si në rastin III. Ndërsa procedura e çregjistrimit të njërit prej ShaUK do të kërkonte praktiken e zmadhimit të kapitalit së bashku me kërkesën për çregjistrimin në QKR me konfirmimet përkatëse nga organet e taksa-tatimeve.

**Rasti 5: Bashkia e Re nuk ka trashëguar Sha UK**

Në ndarjen e re administrativo – territoriale bashkia e krijuar nuk ka të trashëguar Sha UK. Në këtë rast duhet të krijohet një ShA UK e re. Ky rast duhet të referohet krijimit të një shoqërie në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjit për QKR.

Bashkia mund të kryejë themelimin e shoqërisë në 2 mënyra. Mënyra e parë është me kapitalin minimal në vlerë monetare të përcaktuar nga ligji dhe mënyra e dytë me kapital në natyrë.

Dokumentacioni i kërkuar në këtë rast : akt themelimi, statut, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë UK, si dhe dokumentacioni shoqëruar.

**Rasti 6: Bashkia e Re nuk ka organizim të shërbimit UK sipas ligjit të shoqërive tregtare, por si ndërmarrje UK ose U.**

Në ndarjen e re administrativo – territoriale UK nuk ka organizim sipas ligjit të shoqërive tregtare, por figuron si ndërmarrje UK. Në këtë rast duhet të kryhet procedura e transformimit të ndërmarrjes në shoqëri aksionere. Baza ligjore që duhet të referohemi në këtë rast është ligji për transformimin e ndërmarrjeveshtetërore në shoqëri aksionere dhe akte nënligjore në zbatim të tij. Kjo është një praktikë që përdoret nga MZHETTS por në mënyrë analoge mund të përdoret edhe nga bashkitë sa i takon përmbajtjes së akteve që do të hartohen me qëllim ndryshimin e regjimit juridik të UK nga ligji për ndërmarrjet shtetërore tek ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Edhe në këtë rast dokumentacioni është standard: kërkesa për regjistrim, statuti, akti themelimit, raporti ekspertit kontabël, aktet e emërimit të organeve drejtuese, raporti ekspertit vlerësues apo komisioni vlerësimit për efekt transformimi.

**3.3.3 Sugjerime të përgjithshme për Ri-organizimin e Shoqërisë UK**

Veprimi që do të kryhet për të gjitha rastet është zëvendësimi i statutit ekzistues me statutin tip të miratuar me VKM 63. Ndryshimi i statutit në përputhje me statutin tip mund të bëhet në të njëjtën kohë me procedurat e zvogëlimit apo të zmadhimit të kapitalit.

Do të përmbahemi opsionit që rrjedh nga ndarja administrativo-territoriale se duhet të kemi një shoqëri aksionare për çdo bashki.

Në funksion të pikave me sipër ShaUK (sipas pikës 2 të VKM 63/2016) duhet të kryhen procedurat e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit që çojnë në strukturimin e një ShaUK që mbulon me shërbim UK të gjithë territorin e Bashkisë së Re.

Përtej 6 rasteve të evidentuara mund të ketë raste të veçanta të trajtimit të riorganizimit të ShaUK.

**3.4. BURIMET NJERËZORE DHE STRUKTURA FUNKSIONALE**

**3.4.1 Përmbledhje**

Dy çështje kryesore që Bashkia dhe Shoqëria e saj do të duhet të trajtojnë sipas këtij paragrafi janë:

- Kush janë punonjësit e regjistruar që kanë punuar në zonat administrative të shërbyer nga strukturat organizative të komunës?
- Si duhet të ristrukturohet Shoqëria për të trajtuar me përgjegjësi nevojat e ndryshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe / ose kanalizimeve tanimë për zonën administrative të Bashkisë që ka rritje popullore rurale që i shërben?

### **3.4.2 Të dhënat e personelit në strukturat e komunës**

Për komunat që i janë shtuar bashkive të reja dhe që kishin një shërbim formal ujësjellës dhe/ose kanalizime të ofruar nga komuna, ka shumë rëndësi të kuptohet kush kishte përgjegjësitë për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve UK, dhe merrej personel i sistemit operativ. Në këtë drejtim, plani i tranzicionit duhet të dokumentojnë veprimet që do të ndërmerren për të trajtuar këtë çështje të të dhënave të personelit, rekomandohen këto veprime.

- Kontaktoni administratorin vendor dhe personat që kanë punuar për ish-komunat për të dokumentuar se kush janë si dhe të transferojnë të dhënat e tyre personale tek Shoqëria. Në proces, përcaktoni nëse këtyre punonjësve u detyroheni ndonjë pagesë, përfitime, ose pagesa për kontributet shoqërore dhe shëndetësore.
- Vendosin nëse Shoqëria planifikon t'i mbajë këta individë në punë në pozicionin e tyre aktual ose nëse ka bërë plane të tjera për personelin në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.
- Në qoftë se këta individë duhet të pushohen, duhet të dokumentohet saktë që procedura e pushimit nga puna të jetë në përputhje me ligjin dhe të drejtat e tyre si nëpunës publikë.
- Nëse këta individë do të mbeten me Shoqërinë, kontrolloni të dhënat e tyre personale që janë transferuar, krijoni dosjet e personelit në Shoqëri për t'i dokumentuar ata si punonjës zyrtarë të Shoqërisë, për të përcaktuar edhe nivelin e pagës për pozicionin e tyre.

Është e rëndësishme që të gjithë punonjësit e Shoqërisë ta kenë të qarte se si shpërndahen dhe delegohen kompetencat dhe përgjegjësia në Shoqëri, veçanërisht nëse Shoqërisë do t'i shtohet një numër i konsiderueshëm punonjësish për shkak të kalimit të një apo më shumë komunave në bashkinë e re.

### **3.4.3 Struktura e Shoqërisë për trajtimin e zonave të urbane dhe rurale të shërbimit**

Është e kuptueshme se sigurimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat rurale ndryshon jashtëzakonisht nga ai për zonat urbane dhe periferike-urbane. Megjithatë, objektivat e performancës që po shqyrtohen nga qeveria kanë për qëllim ta "ngushtojnë hendekun në cilësinë e shërbimit të ofruar" në mënyrë të konsiderueshme në dhjetë (10) vitet e ardhshme. Duke pasur parasysh këtë drejtim të politikës, Shoqëritë rekomandohen të strukturoren vetë në mënyrë të atillë që të krijojnë kapacitetin dhe aftësinë për të siguruar një shërbim cilësor të balancuar, qoftë në zonat urbane apo rurale.

Kjo do të kërkojë përmirësimin e lëvizshmërisë dhe komunikimit të personelit si dhe më shumë investime kapitale në teknologjitë që lejojnë monitorimin e objekteve pa personel si p.sh. stacionet e pompimit, rezervuarët dhe nyjet e klorinimit. Shoqërive do t'u duhet të kenë vendosur ekipe operative strategjike në zonat rurale të cilat mund të menaxhohen në mënyrë rutine nga zyra qendrore.

Përveç kësaj, Shoqërive do t'u duhet të parashikojnë në buxhet dhe të shpenzojnë më shumë nga fondet e tyre për trajnimin e personelit rregullisht për t'u siguruar se ata janë të përgatitur për të operuar dhe mirëmbajtur sisteme teknologjikisht shumë më të sofistikuar. Ky trajnim ofrohet nga Shoqata e Ujësjetës-Kanalizimeve të Shqipërisë ([www.shukalb.al](http://www.shukalb.al))

### **3.5. ASPEKTE TEKNIKE DHE OPERACIONALE**

#### **3.5.1 Përmbledhje**

Shtimi i ish komunave tek bashkiasi pasojë e reformës territoriale, do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe serioz tek bashkia e re dhe tek Shoqëria e saj për sa i përket funksionimit dhe mirëmbajtjes të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Po ashtu, do të ketë një ndikim edhe më të madh tek çështja e riparimit të kapitaleve dhe zëvendësimin e të gjithë aseteve të sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në pronësi publike që ekzistojnë në këto ish-komuna, pasi ka shumë mundësi që ato të jenë shumë të vjetra dhe të pamirëmbajtura. Kjo mund të ndërlikohet edhe më shumë, nëse Shoqëria nuk ka zbatuar zyrtarisht një program për menaxhimin e aseteve të veta për sistemin e objekteve në pronësi të saj.

Identifikimi, regjistrimi dhe vlerësimi i gjendjes së aseteve të Shoqërisë publike të ujësjetës-kanalizimeve në ish komunat që tani janë pjesë e bashkisë së re është një veprim që duhet të ndërmerret urgjent dhe që kërkon vëmendje të plotë të Shoqërisë.

#### **3.5.2 Inventarizimi Fizik i Aseteve të Sistemeve të ish Komunave**

Bashkia/Shoqëria duhet të planifikojnë menjëherë kryerjen e një inventari të objekteve fizike të të gjithë aseteve në ish komunave të cilat nuk kanë qene pjesë e asnjë shoqërie UK, si ato të luajtshme ashtu edhe të patundshme, që iu shtuan Bashkive të reja në kuadër të reformës territoriale. Ky inventar i aseteve fizike duhet të përfshijë si minimum:

- Vendndodhjen fizike të secilit objekt në hartë dhe të koordinojë vendndodhjen;
- Dokumentimin me fotografi të të gjitha pasurive të dukshme;
- Lloji, madhësia, materiali i aseteve dhe çdo tipari tjetër përkatës.
- Gjendja funksionale dhe besueshmëria e përcaktuar për performancën e çdo aseti; plus gjykimi për rrezikun e afërt të moshës së aseteve për shkak të gjendjes së saj;
- Data e ndërtimit/instalimit të çdo aseti.
- Kostoja e përafërt aktuale për zëvendësimin e secilit prej aseteve.
- Vlera aktuale e përafërt në gjendje të re të çdo aseti.



### **3.5.3 Investimet aktive në zonat e ish komunave**

Është e rëndësishme të mësojmë për çdo projekt aktual apo plan të afërt për investime kapitale në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat e ish komunave. Ky informacion duhet të vihet në dispozicion nga DPUK, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) dhe ose Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Duhet të rregullohen menjëherë takime për të mundësuar ripërcaktimin e kontakteve zyrtare me Bashkinë dhe Shoqërinë UK dhe të “detyrimeve aktuale dhe të ardhshme të pronarit”.

### **3.5.4 Sistemi i administrimit të mirëmbajtjes**

Nuk është asnjëherë vonë për të ndërmarrë një nismë për zbatimin e një sistemi formal, të kompjuterizuar të administrimit të mirëmbajtjes. Gjatë kësaj kohe ndryshimesh dhe tranzicioni, nëse Shoqëria nuk po përdore aktualisht një sistem të tillë, emergjenca e marrjes së një sërë asetesh të plakura në komunat e shtuara së fundmi duhet të shërbejë si nxitës për të konsideruar planifikimin dhe me pas instalimin e një sistemi të tillë.

Nëse Shoqëria nuk ka një sistem të informatizuar të administrimit të mirëmbajtjes, ajo nuk ka as mundësinë për të menduar për sipërmarrjen e administrimit të shëndetshëm dhe të besueshëm të asetëve. Prandaj, rekomandohet që sistemi i administrimit të mirëmbajtjes të bëhet pjesë e planit të tranzicionit dhe më vonë të jetë Qëllim Strategjik në Planin e Biznesit.

## **3.6. SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT**

### **3.6.1 Përmbledhje**

Konsumatorët që më parë shërbeheshin nga komuna dhe që ndodhen në komuna por i janë shtuar bashkisë së re, si rezultat i reformës territoriale, duhet të njihen menjëherë si klientë të Shoqërisë në pronësi të bashkisë. Marrëdhëniet e tyre me Shoqërinë duhet të formalizohen dhe legalizohet sa më shpejt të jetë e mundur.

Në të ardhmen e afërt, mund të ketë çështje ligjore në aspektin e marrëdhënieve formale që Shoqëria e ujësjellës-kanalizimeve mund të ketë me këta konsumatorë, duke qenë se këta konsumatorë janë jashtë zonës së shërbimit të licencuar të Shoqërisë UK, dhe nuk do të jetë e ligjshme për Shoqërinë të faturojë dhe mbledhë tarifën si transaksion financiar të Shoqërisë. Prandaj, bashkia dhe Shoqëria e ujësjellës kanalizimeve duhet të strukturojnë një marrëveshje siç diskutohet më poshtë.

### **3.6.2 Dokumentacioni i konsumatorëve**

Administratorët që janë emëruar për të përfaqësuar bashkinë në ish komuna të ndryshme duhet të udhëzohen që t'i sigurojnë Shoqërisë të gjitha të dhënat e konsumatorëve që kanë. Me këto burime materiale, departamenti i shërbimit ndaj klientit i Shoqërisë duhet të kryejë verifikime në terren të çdo lidhjeje me sistemin e shpërndarjes për të konfirmuar të gjitha lidhjet e regjistruara dhe për të identifikuar ndonjë lidhje të paregjistruar (të paligjshme).

### **3.6.3 Faturimi i konsumatorëve dhe arkëtimet**

Derisa Shoqëria të ketë aplikuar dhe marrë, nga ERRU, një rishikim të licencës së saj, e cila do të përfshijë komunat që i janë shtuar në bashkisë së re, si rezultat i reformës territoriale, kjo Shoqëri nuk mund të faturoje dhe të arkëtojë zyrtarisht nga konsumatorët në ato zona në emrin e vet. Kjo mund të zgjidhet duke u kërkuar konsumatorëve nga këto zona të nënshkruajnë një kontratë të përkohshme të shërbimit me bashkinë, që do të zbatohet nga Shoqëria e ujësjellës kanalizimeve, në emër të bashkisë.

### **3.6.4 Tarifa Fillestare**

Duke qenë se shumica e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që ishin nën kontrollin operacional të komunave nuk kishin lidhje të konsumatorëve me matës, atëherë është e arsyeshme të pritët nëse ata kishin një tarifë, kjo ishte tarifë fikse afrofe. Rekomandimi është që të ruhet ky nivel tarife derisa Shoqëria e ujësjellës kanalizimeve t'i bëjë kërkesë zyrtare ERRU, pasi të ketë përgatitur një plan të saktë biznesi.

Nëse Shoqëria evidenton se klientët nuk faturoheshin fare dhe se kostoja e furnizimit me ujë dhe kanalizime përfshihej në një farë mënyre në buxhetin e komunës, atëherë rekomandohet që Shoqëria UK të miratojë me bashkinë një, tarifa fillestare fikse derisa kërkesa zyrtare për ndryshimin e tarifave të jetë miratuar nga ERRU.

## **3.7. ASPEKTE RREGULLATORE**

### **3.7.1 Përmbledhje**

Nuk është e qartë nëse do të ketë VKM të tjera, urdhra ose rregulla të tjera që do të trajtojnë ndikimin e reformave të tjera në ERRU. Në mënyrë të qartë, ERRU do të mbytet nga kërkesat për dhënien e licencave të reja, siç kërkohet në VKM e reformës dhe në autoritetin aktual të ERRU. Po kështu, ERRU patjetër do të vërshojnë kërkesa për ndryshimin e tarifave sapo Shoqëritë e reja të licencuara e të ri-organizuara të kenë përgatitur planet e biznesit dhe parashikimet për nevojat për të ardhura.

### **3.7.2 Licencimi dhe ndryshimi i tarifës**

Sipas reformës, Shoqëritë UK duhet të aplikojnë tek ERRU brenda tre muajve pas riorganizimit të tyre, për një licencë të re dhe ndryshim të tarifave të shërbimit.

### **3.7.3 Kërkesa për zgjatjen e afatit të dorëzimit**

Duke qenë se Shoqërisë së riorganizuar Ujësjellës Kanalizimeve do t'i duhet kohë për hartimin e një plan të përshtatshëm biznesi për të përcaktuar nevojat e të ardhurave dhe nevojën për ndryshimin e tarifave, bashkia dhe ShoqëriaUK duhet të kërkojnë shtyrje të afatit ose të njoftojnë ERRU për kohën e nevojshme për përfundimin e procesin të planit të biznesit.

#### **4. STRUKTURA DHE RËNDËSIA E PLANIT 5-VJEÇAR PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS DHE E PLANIT TË BIZNESIT**

Procesi i hartimit të planit të biznesit është metodë e provuar për përcaktimin e qëllimeve, hartimin e planeve të përmirësimit të performancës, përcaktimin e përgjegjësive, evidentimin dhe përcaktimin e nevojave për shpenzime kapitale dhe operative, dhe përcaktimin e nevojave për të ardhura dhe strategjitë të tarifave si dhe të matjes së performancës.

Më poshtë jepen elementët e procesit zyrtar të hartimit dhe zbatimit të planit të biznesit të Shoqërisë ujësjellës-kanalizime që është standard në Shqipëri. Ky proces i planifikimit të biznesit është zhvilluar për Shqipërinë nën asistencën teknike të Bankës Botërore . Manuali për planifikimin e biznesit të Shoqërisë ujësjellës-kanalizimeve, së bashku me një formatet në Microsoft Excel mund të merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve (DPUK).

Trajnimi në përdorimin e këtij procesi të planifikimit të biznesit është vënë në dispozicion nga Shoqata e Ujësjellës-Kanalizimeve e Shqipërisë (SHUKALB) me kursin e parë të planifikuar për në shtator 2016. Programi për të gjitha kurset e trajnimit të planifikuara për t'u dorëzuar nga SHUKALB mund të gjenden në faqen e internetit të shoqatës.

##### **4.1 Deklarata e vizionit dhe misionit**

Ky është hapi i parë në procesin e zhvillimit të Planit të Biznesit dhe edhe pse menaxherëve të cilet e ndjekin këtë proces për here të pare, u duket gjithmonë si diçka e pakuptimtë, ata shpejt kuptojnë se deri sa të përcaktojnë qartësisht vizionin dhe misionin e Shoqërisë së tyre, ata nuk mund të fillojnë t'i përkthejnë ato në veprimet e nevojshme për të realizuar këtë vizion dhe mision.

##### **4.2 Përmbledhje për drejtuesit e lartë**

Ky seksion i planit të biznesit përgatitet pasi të ketë përfunduar plani i biznesit dhe u ofron drejtuesve të lartë mundësi për të dhënë një shpjegim përmbledhës të situatës dhe për të komunikuar shqetësimet përkatëse dhe metoda për përmirësimin e performancës.

##### **4.3 Qëllimet strategjike**

Përcaktimi i qëllimeve strategjike është çelësi për procesin e planifikimit të biznesit, duke qenë se qëllimet strategjike kapin objektivat e matshëm që matin përmirësimin e performancës për Shoqërinë. Qëllimet Strategjike hartohen për të qenë **specifikë, të matshëm, realistë**, dhe me **afate kohore**. Ky është çasti kur drejtuesit e lartë fillojnë ta marrë vërtetë seriozisht procesin e planifikimit, duke qenë se këto qëllime do të jetë baza e marrëveshjes për performancën midis Shoqërisë dhe Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Qëllimet strategjike për t'u identifikuar do të lidhen kryesisht në mënyrë të drejtpërdrejte me "treguesit e performancës" në Programin të Monitorimit dhe

Matjes së Performancës të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizimeve. Disa tregues kyç të performancës që janë shqetësuese aktualisht në Shqipëri janë si më poshtë:

| <b>Treguesit kyç të performancës</b>  |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Uji i pafaturuar/humbjet (prodhimi që nuk faturohet)</li> </ul>                              | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vazhdimësia e shërbimit (orët në ditë që rrjeti është nën presion)</li> </ul>                       |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Efikasiteti i personelit (nr. i personelit për 1,000 lidhje)</li> </ul>                      | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kostot e operacioneve dhe mirëmbajtjes dhe mbulimi i tyre nga arkëtimet</li> </ul>                  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Efikasiteti i arkëtimeve (Përqindja e faturave të muajve të mëparshëm të paguara)</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbulimi total i kostove nga arkëtimet (kjo përfshin shlyerjen e borxhit dhe amortizimet)</li> </ul> |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përqindja e matur e prodhimit të ujit</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përqindja e matur e lidhjeve të konsumatorëve</li> </ul>  |

#### **4.4 Analiza dhe parashikimi për menaxhimin e kërkesës për ujë**

Menaxhimi i kërkesës për ujë nuk është kuptuar mirë në ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë. Në vendet në tranzicion, ku "shifrat" nuk u duhej kurrë të përmbushin provën e realitetit të tregtisë, mungesat ishin thjesht një barrë që duhet të duronin konsumatorët, pa u ankuar, dhe për këtë arsye administrimi i kërkesës për ujë nuk ishte një problem i drejtuesve të Shoqërive UK. Parashikimi dhe analiza për menaxhimin e kërkesës për ujë është procesi ku fillon matja dhe llogaria për ujin, si një produkt i prodhuar, që duhet të shitet, dhe jo të humbasë.

Analizë dhe parashikimi janë çështje të vështira për Shoqëritë ujësjetllës-kanalizimeve për të kuptuar kush është duke e shfrytëzuar ujin, dhe se si ndryshon përdorimi sipas ditës, javës, muajit dhe vitit, në mënyrë që Shoqëria t'i përgjigjet mirë luhatjeve e kërkesës si dhe kërkesës mesatare.

Kjo analizë është pikërisht çasti kur Shoqëria e ujësjetllës-kanalizimeve duhet ta marrë me seriozitet trajtimin e një nga sfidave më të mëdha me të cilat përballet sektori i furnizimit me ujë në Shqipëri, që është niveli i lartë i ujit të pafaturuar (UPF). UPF është vëllimi i ujit që prodhohet dhe dërgohet në rrjet (sistem), por është shumë më i madh se vëllimi i ujit që mund të llogaritet duke shtuar të gjithë e ujin e shitur dhe të gjitha faturat e lëshuara nga Shoqëria. "Ujë i pafaturuar" (UPF) ishte i kushtueshëm për t'u prodhuar dhe shpërndarë, por në thelb ai humbet dhe shpesh kjo humbje është rezultat i menaxhimit të dobët dhe praktikave të dobëta tregtare dhe jo thjesht humbje teknike për shkak të rrjedhjeve apo çarjeve.

#### **4.5 Struktura Organizative dhe Personeli**

Duke qenë se performanca të mund të arrihet vetëm nga njerëzit, struktura organizative dhe kualifikimi i personelit janë komponentët kryesorë të Planit të Biznesit. Është një praktikë e zakonshme që Shoqëritë e shërbimeve publike, siç janë Shoqëritë ujësjellës-kanalizimeve, të shërbejnë si Shoqëri punësimi për arsye politike, gjë që rezulton në rritje të panevojshme të personelit dhe në shpenzime tepër të larta. Ky proces do të evidentojë edhe më shumë koston e krahut të punës në buxhetin e përgjithshëm dhe presioni që ka mbipopullimi i personelit të Shoqërisë në nivelin pagave që mund të përballojë Shoqëria për personelin.

#### **4.6 Programi për Përmirësimin e Performancës**

Pasi të jenë përpiluar qartë Qëllimet Strategjike dhe struktura organizative dhe personeli, drejtuesit e lartë mund të vendosin në lidhje me detajimin e programeve të veçanta për përmirësimin e performancës që duhet të ndërmerren për të arritur qëllimet strategjike të përcaktuara më parë. Këto Programe për Përmirësimin e Performancës janë mjaft të detajuara, me afate të qarta për arritjen e objektivave dhe të zbatimit. Një nga nënproduktet e Programit të Përmirësimit të Performancës është identifikimi i investimeve kapitale që do të duhet të bëhen për të arritur përmirësimin performancës. Këto investime do të shërbejnë për të ndihmuar hartimin e planit të investimeve kapitale për pesë vitet e parashikuara.

#### **4.7 Programi pesëvjeçar për investimet kapitale**

Shpenzimet kapitale ishin zakonisht vendim i qeverisë qendrore në shumë vende në botë. Shpesh në nivel vendor ka pak përvojë ose ekspertizë që duhet për të hartuar një program investimesh kapitale, program i cili të lidhet me prioritetet e performancës efikasitet të kostos. Ky element i Planit të Biznesit është jashtëzakonisht i dobishëm në këtë drejtim dhe tregon se “nuk mund t’i kemi të gjitha”. Programi i Investimeve Kapitale jo vetëm që do të përcaktojë nevojat për kapital, por edhe të marrë në konsideratë dhe zhvillojë alternativa për plotësimin e këtyre nevojave.

#### **4.8 Buxheti 5-vjeçar për operacionet mirëmbajtjen**

Me informacionin e mësipërm, ekipi i drejtuesve të lartë mund të vendosë tashmë të marrë në konsideratë se si do të jetë buxheti për operacionet dhe mirëmbajtjen gjatë pesë viteve të ardhshëm. Çështjet kyç për buxhetin janë ndikimi i vendimeve të drejtuesve për shpenzimeve për krahun e punës, energjinë elektrike dhe kimikatet. Këto tri çështje janë pikat kryesore të buxhetit për shumicës e Shoqërive ujësjellës-kanalizime.

#### **4.9 Nevoja për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve**

Drejtuesit në ditët e sotme të Shoqërive ujësjellës-kanalizimeve po mësojnë se shpenzimet dhe nevojat e të ardhurave janë të lidhura, por jo të njëjta. Ata kanë filluar të vlerësojnë rëndësinë e përcaktimit të shumës së duhur për

dhënien e parave të nevojshme për transferimin në fondet e ndryshme rezervë kapitale, të cilat përfshijnë:

- Fondi i Rinovimit të Kapitalit
- Fondi i Riparimit dhe Zëvendësimit të Kapitalit
- Fondi i Investimeve të Reja Kapitale

Është e rëndësishme në shërbimet me shumë kapitale, si furnizimi me ujë dhe kanalizimeve, që Shoqëria dhe bashkia të kuptojnë se si duhet të faktorizohen ato në buxhetin si "nevoja për të ardhura", në mënyrë të rregullt kohore, me qëllim që të jenë në gjendje të t'i reflektojnë siç duhet në llogaritjen e tarifës kështu që rezervat për financimin e kapitalit të jenë përlllogaritur saktësisht.

Procesi i planit të biznesit përfundon me një seri procesesh të analizës së tarifave që mund të bëjë që drejtuesit të rishohin planet e veprimit dhe buxhetin e operacioneve dhe mirëmbajtjes. Pasi të jetë llogaritur "tarifa mesatare" realiste, mund të hartohet strategjia e çmimit për të reflektuar ndonjë dallim mes kategorive të përdoruesve (klientëve).

Sipas Reformës Administrative-Territoriale dhe reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, shumicës së bashkive dhe Shoqërive të tyre ujësjellës-kanalizime do t'u duhet të rishqyrtojnë dhe ndryshojnë strukturën e tarifave për të plotësuar nevojat e tanishme dhe të ardhshme për të ardhura. Për këto ndryshime të tarifave do të duhet miratimi i ERRU.

Në aplikimin e metodologjisë për përcaktimit e tarifave, ERRU mund të jetë më e kuptueshme për sa i përket nevojave për të ardhura të Shoqërive ujësjellës-kanalizime, pasi të kenë pasur mundësinë për të shqyrtuar planin 5-vjeçar të përmirësimit të performancës dhe planin të biznesit, për të marrë një ide më të mirë të veprimeve që propozohen të marren me qëllim përmirësimin e performancës dhe se si janë llogaritur të ardhurat e nevojshme për të mbështetur këto përmirësime.